



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Belsh më: 16. 09 .2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Furnizim vendosje mobilje për ambientet e zyrave të Bashkisë Belsh”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Mobilje per zyra(39130000-2)**

VLERA E FONDIT LIMIT: **2 481 565** *(dy milion e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.*

Perllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike, kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kryer nga Komisioni i ngritur me urdher te titullarit nr.1779prot., date 16.05.2025, referuar nenit 76 të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton se Në perllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet ti referohet një ose më shumë alternativave të rënditura si më poshte:a) “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”

b)studimit të trgut, bazuar në mesataren e cmimeve të marra nga ky studim

c)cmimet e kontratave të mëparëshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritetet të tjera kontraktore,

ç)cmimet ndërkombëtare të shpalluara publikisht,

Në përfundim të punës grupi i punës u referua në nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, pika 1a a)çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe

informacionit të mbledhur të zërave të mallrave bazuar në Urdhërin e Administratorit të Operatorit të Blerjeve të Përqendruara sh.a Nr. 44, datë 17.05.2024 “Për miratimin e katalogut të standardeve për objektin e prokurimit: Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim”ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar bazuar në proceverbalin e hartuar nga specialistët e fushës me Nr.3212prot., datë 10.09.2025, me përmbajtjen si më poshtë:

Hartimi i dokumenteve të tenderit u bë në përputhje me ligjin Ligjin Nr. 162/2020 date 23.12.2020 “Për Prokurim Publik” i ndryshuar si dhe VKM nr 285 date 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(I ndryshuar).

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26,30 , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;...2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.”

Gjithashtu nënin 44 “Kërkesat e cilësisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma

ndërkombëtarëakreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë tëargumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se: Referuar ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” operatorët ekonomikë të cilët nuk kanë detyrimin ligjor të liçencohen nga QKB-ja, duhet të paraqesin Ekstraktin Tregtar, të cilët në fushën e veprimtarisë duhet të kenë të përfshirë objektin e prokurimit.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale si më lart duke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, kualifikimeve dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë në lidhje me garantimin e zbatimit në veprimtarinë e tyre të standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022-**2023-2024**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se 40% e vlerës së parashikuar në kontratë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”

Si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: “Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e permbyshur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në: Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore në një vlerë, jo më pak se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2022, 2023, 2024) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuar të bilanceve të 3(tri) viteve të fundit financiare(2022,2023,2024) të shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, I ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

Shënim:Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE Vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar “ I ndryshuar, ku parashikohet se:”Personat juridic që detyrohen për auditim ligjor të pasqyrave financiare detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspert kontabël ose shoqëri audituese:”c)shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite rradhazi, tejkalojnë dy prej treguesve të mëposhtëm:** i)totali I aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milion lekësh ; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milion lekësh ; iii)ja, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP si dhe nenin 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” I ndryshuar.

Përcaktimi I viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar , Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006”Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin29 të ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “ për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore Brenda datës 31 mars

të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me ankeset e tij, si dhe cdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Fiancës në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqëimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c) të Ligjit nr.1009/2009: “Personat juridik që detyrohen për auditim ligjor të pasqyrave financiare detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspert kontabël ose shoqëri audituese:”c)shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite rradhazi, tejkalojnë dy prej treguesve të mëposhtëm:** i)totali I aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milion lekësh ; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe **vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin e fundit (këstet e maturuara), duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore(këstet e maturuara për vitin 2025)**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,**, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2, e LPP, dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nëni 4, pika 2 d).

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme, kërkohen dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati I përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Në nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4/b të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë

në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala "kërkon" nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kriteret për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4/b të nenit 55 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme : - ISO 9001 : 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente të vlefshme dhe të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: *Kjo kërkesë është vendosur duke u mbështetur në nenin 79, pika 1 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar "Standartet e sigurimit të cilësisë dhe standartet e menaxhimit mjedisor" dhe nenin 44, pika 1 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Për vetë natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatori ekonomik të jetë i certifikuar për cilësinë, të kryejnë veprimtarinë me standartet e kërkuara të cilësisë. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen dhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.*

2.3.3 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të cilësojë se mallrat e ofruara prej tij, janë të reja dhe jo të përdorura apo të rikonstruktura.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie të mallrave që kërkohej të prokurohen nëpërmjet së cilës duhet të marrë përsipër dhe të garantojë : riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe transportit për një periudhë 24(njezet e kater) muajsh nga koha e marrjes në dorëzim të artikujve nga autoriteti kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, nga nënshkrimi i kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponibilitet të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK. Deklaratat e mësipërme janë kërkuar pasi janë të nevojshme për zbatimin e kontratës me sukses dhe për të siguruar cilësinë e mallrave pasi mund të gjendemi para faktit që këto*

mallra të jenë të një cilësie të dobët ose të kenë defekte fabrikimi, ndaj OE duhet të jetë i gatshëm për zëvendësimin e tyre dhe i shërben AK për njohjen e reputacionit dhe besueshmërisë së OE.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Referuar procesverbalit me Nr.3212prot., datë 10.09.2025 janë hartuar në varësi të objektit të kontratës nga Komisioni i hartimit të fondit limit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta të kualifikimit krijuar me Urdhër. Nr.3112prot, datë 01.09.2025 , ku bashkëlidhur ka dërguar specifikimet teknike objekt prokurimi, specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020“Për Prokurimin publik”, dhe nenin 40 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

*Specifikimet teknike, të hartuara për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë elementet më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, dhe çdo standard të kërkuar**, referuar kërkesave dhe standarteve ndërkombëtare për automjetet.*

Njësia e Prokurimit